

 Republika e Kosovës Republika Kosova Republic of Kosova	DREJTORIA PËR PLANIFIKIM URBAN DHE MJEDIS		 Komuna e Istogut Opstina Istok Municipality of Istog
	Nr. I lëndës 11-351-52146/140	Datë: 12.01.2023	

Bazuar në Ligjin e Ndërtimit, Nr. 04/L-110, nenet 14, 15, 19, 20 dhe 21 dhe Ligjit për Procedurën Administrative Nr. 05/L-031, neni 3 i Rregullores komunale për taksa, ngarkesa dhe gjoba për lëshimin e Lejës ndërtimore për objektin investiv- **Ndërtesë e banimit individual** në Istog të Poshtem si dhe aplikacionit dhe dokumenteve të paraqitura sipas kërkesës me nr. 11-351-52146 të dt. 07.12.2022 në emër të pronarit **Rameza Shabotiq**, , Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mjedis në Istog lëshon:

VENDIM PËR LEJE NDËRTIMORE

Kjo Leje Ndërtimore i lëshohet:			
Emri:	Rameza Shabotiq nga Banja, Komuna e Istogut		
Adresa:	rr. "Arbëri" pn _____ Carrallukë		
Telefoni:		Emaili:	

Emri i Projektit:	NDËRTESE BANIMI INDIVIDUAL P+1K		
Emri i Projektuesit:	1. Drilon Isufi, ark. Ing. 2. Halit Kabashi, idgj		
Adresa:	Studio projektuese "Arch-ART" në Istog		
Telefoni:		Emaili:	

Për punët ndërtimore në vijim:		
Adresa: rr. "Arbëri" pn _____ Carrallukë		
Zona(t) Kadastrale: Carrallukë	Nr. i parcelave kadastrale: 00021-31	GPS Koordinatat:

Lloji i ndërtimit të propozuar:		
Ndërtim i ri ☒	Rindërtim ☐	Riparim ☐

Kategoria e ndërtimeve të propozuara:	
Kategoria I ☒	Kategoria II ☐
Përdorimi i propozuar:	A përfshin kërkesa ndryshim të destinimit? Po ☐ Jo ☐
Përshkrimi: Ndërtesë e banimit individual P+1K në Carrallukë	

Me këtë vendim, poseduesit të Lejes ndërtimore **Rameza Shabotiq nga Banja** lejohet ndërtimi i Ndërtesës banimore individual P+1K në Carrallukë

Poseduesi i Lejes Ndërtimore është i obliguar që:

- Të fillojë me punët ndërtimore brenda një (1) viti nga data e dhënies së kësaj leje ndërtimore, përveç nëse zgjatet afati i vlefshmërisë së saj në pajtim me Ligjin;
- Te vendose tabelën informuese në vendndërtim me informatat e mëposhtme:
 - informata mbi Lejen Ndërtimore
 - informatat mbi projektuesin
 - informata mbi kontraktuesin
 - prezantimi grafik i dukjes së ndërtimit
- Të sigurojë që kontraktuesi në vendndërtim posedon dokumentet e mëposhtme:
 - një kopje të kësaj leje ndërtimore;
 - një kopje të kontratës ndërmjet poseduesit të lejes ndërtimore dhe kontraktuesit nëse punët ndërtimore kryhen nga një palë e tretë;
 - një kopje të të gjitha dokumenteve të ndërtimit që janë nënshkruar ose vulosur si të "APROVUAR" nga organi kompetent;
 - projektin kryesor me të gjitha fazat për nevojat e realizimit të ndërtimit;
 - dokumentacionin që tregon konformitetin e produkteve të ndërtimit dhe pajisjeve me kërkesat rregullative, dhe me dokumentet e aprovuara të ndërtimit;
 - librin dhe ditarin ndërtimor, që duhet të përmbajë regjistrin e hollësishëm ditor të të gjitha punëve ndërtimore, përfshirë të dhëna të shkruara dhe skematike, që dokumentojnë: datën, vendin dhe rezultatet e testeve të kryera në materialet ose punët ndërtimore; Përshkrim të problemeve të hasura gjatë ndërtimit dhe inspektimit dhe mënyrën se si janë zgjidhur si dhe;
 - protokollin e miratuar të nevojshme për aplikim për certifikatë të përdorimit;
- Të dorëzojë njoftim inspektoratit të Organit Kompetent për fillimin e ndërtimit së paku shtatë (7) ditë para fillimit të punëve ndërtimore;
- Të njoftojë organin kompetent për të kryer inspektimet siç kërkohet me ligj, dhe akte nënligjore. Këto inspektime nuk e lirojnë aplikuesin për leje ndërtimore dhe/ose arkitektin apo inxhinierin e licencuar përgjegjës për sigurimin e inspektimeve adekuata dhe mbikëqyrje ditore të punëve ndërtimore;
- Të njoftojë organin kompetent për ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga projektuesi. Poseduesi i Lejes Ndërtimore duhet të njoftojë organin kompetent për të gjitha ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga projektuesi përveç në rastet kur:
 - ndryshimet nuk janë në kundërshtim me KN, Kodin dhe rregulloret teknike në fuqi;
 - ndryshimet në dimensionet e pjesëve të jashtme të ndërtimit nuk tejkalojnë 2% dhe zero pjesë një (0,1) metër por që nuk tejkalojnë vijën ndërtimore;

- o ndryshimet në organizimin e brendshëm janë në harmoni me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret teknike në fuqi;
- Të aplikojë për certifikatë të përdorimit pas përfundimit të punëve ndërtimore, në pajtim me Ligjin dhe aktet nënligjore.

Arsyetim

Aplikuesi **Rameza Shabotiq nga Banja**, Komuna e Istogut me nr. të kërkesës 11-351-52146 të dt. 07.12.2022 ka kërkuar nga organi kompetent DPUM lëshimin e Lejes Ndërtimore për ndërtimin - Ndërtesë e banimit individual P+1K në Carrallukë në parcelën kadastrale me nr. 00021-31 ZK Carrallukë.

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit të ndërtimor të lëndës, si dhe bazuar në Ligjin Nr.04/L-110 për Ndërtim, Ligjin Nr. 05/L-031 të Procedurës Administrative dhe dispozitat tjera të ligjit në fuqi, u konstatua se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara ligjore për lëshimin e **Lejes Ndërtimore**, andaj u vendos si në dispozitiv.

Kjo Leje Ndërtimore bazohet në shqyrtimin e provave:

- Dokumentacioni pronësores juridik
- Tri kopje të projektit ideor dhe kopje elektronike - për Kategorinë e I-rë
- Dëshmi mbi zotimin e mjeteve për pagesën e taksave
- Te tjera

Shtojcë: Lejes së ndërtimit i bashkëngjitet: situacioni i ngushtë, dispozita urbanistike e pozicionimit të objektit me koordinata, në sistemin koordinativ KOSOVAREF01.

Udhëzim juridik: Pala e paknaqur me këtë vendim, përnes kësaj Drejtorie, me ankesë mund t'i drejtohet MMPHI në Prishtinë brenda afatit prej 30 ditësh bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI.

Nga një kopje të këtij vendimi t'i dërgohet: parashtruesit të kërkesës QSHQ, kësaj Drejtorie, Drejtorisë për inspektim dhe Arkivës.

Udh. I sektorit
Ark. Rexhep Blakaj id,



Drejt. Dukagjin Hoxhaj,

